



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

---

Numri i lëndës: 2020:178980  
Datë: 04.04.2024  
Numri i dokumentit: 05547829

**CP.nr.278/2022**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil,** si me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përbarimore të kreditorit Rr. I. te cilin e përfaqëson me autorizim avokat Berat Peci, me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit T. Sh. A. - M., lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përbarimor - Aktgjykimi Cnr. 1468/2020, te datës 26.03.2021, të lejuar me aktvendimin për përbarim CP 278/22, te datës 22.04.2022, jashtë seance gjyqësore, me datën 04.04.2024 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDOHET** procedura përbarimore e udhëhequr sipas shenjës CP 278/22, me kreditor Rr. I. ndaj debitorit T. Sh. A. - M., për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

**A r s y e t i m**

Kreditori i përbarimit Rrahim Ibrahim i te cilin e përfaqëson me autorizim avokat Berat Peci, me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit T. Sh. A. - M., ka paraqitur propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor - Aktgjykimi Cnr. 1468/2020, te datës 26.03.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përbarimit, me aktvendimin CP 278/22, te datës 22.04.2022, ka lejuar përbarimin ndaj debitorit T. Sh. A.- M.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 278/22, te datës 22.04.2022, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt...., ka njoftuar gjykatën se debitori i përbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore*”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2020:178980  
Datë: 04.04.2024  
Numri i dokumentit: 05547829

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**CP.nr.278/2022 më datë 04.04.2024**

Gjyqtari  
Genc Hasani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.